



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:088882
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05481470

C.nr.612/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Mirjeta Shala,, në çështjen juridike të paditësit K.- Distrikti në Gjakovë e përfaqësuar nga T.G., me autorizim në lëndë, kundër të paditurit A.SH.J.,nga Gjakova, rruga “.., me objekt kompensim demi material, jashtë shqyrtimit, me datë 20 mars 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET marrëveshja jashtëgjyqësore Nd.nr.09/24, e datës 05.03.2024 e lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Gjakovë, në mes të paditësit K...- Distrikti në Gjakovë, kundër të paditurit A.J., nga Gjakova në çështjen juridike civile. Për Kompensim demi material, dhe e njëjta e ka fuqinë e titullit përmbarues.

II. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është marrëveshja e ndërmjetësitimit Ndr.nr. 09/24 e datës 05.03.2024

A r s y e t i m

Gjykata, përmes njoftimit të datës 19.01.2024 i ka ftuar palët ndërgjyqëse që çështjen kontestimore ta zgjidhin në procedurën e ndërmjetësitimit, dhe pas shprehjes së vullnetit nga palët, me vendimin numër C.nr.612/21 të datës 19.01.2024, e ka referuar lëndën në Qendrën për ndërmjetësim në Gjykatën Themelore Gjakovë për veprim të mëtejme, e cila është regjistruar me numrin e referencës së ndërmjetësitimit Ndr.nr.09/24.

Qendra për ndërmjetësim në Gjykatën Themelore Gjakovë, me datë 05.03.2024 në rastin konkret e ka njoftuar gjykatën se palët kanë me arritur që kontestin lëndor të e zgjidhin me marrëveshje jashtëgjyqësore në Qendrën e Ndërmjetësitimit ashtu që gjykatës ia ka dorëzuar ekzemplarën e marrëveshjes për zgjidhjen e kësaj çështje sipas procedurës së ndërmjetësitimit.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes së palëve në procedurë të arritur me ndërmjetësim, ka konstatuar se e njëjta nuk është lidhur në kundërshtim me Ligjin dhe për këtë arsye bazuar edhe në dispozitat ligjore të nenit 3 par. 3.3, nenit 411 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore LIGJI Nr. 03/L-006 lidhur me nenin 4, 5, 11, 12, 14, 15 par.1 dhe nenit 17 të Ligjit për Ndërmjetësimin me nr.06/L-009 erdhi në përfundim se marrëveshja jashtëgjyqësore duhet të aprovet dhe si e tillë e njëjta e ka fuqinë e titullit përmbarues.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.612/21, datë 20 mars 2024.

Gj y q t a r j a,

Mirjeta Shala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Numri i lëndës: 2021:088882
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05481470